

## Vendim nr. 151 datë 28.06.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 28.06.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 7 (D) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUESE:**

**DASHMIRA ZARO**

**OBJEKTI:**

**Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 443, datë 18.07.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër.**

**Konstatimi i cenimit të së drejtës së pronës si pasojë e kohëzgjatjes së kufizimeve të vendosura mbi të me anë të VKM-së nr. 322, datë 15.04.2015.**

**BAZA LIGJORE:**

**Nenet 17, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Dashmira Zaro ka përfitur tokë në zonën kadastrale nr. 8541, në zonën e emërtuar Virua, Gjirokastrë. Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 322, datë 15.04.2015 (VKM nr. 322/2015) ka vendosur të shpronësojë për interes publik pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projekteve në Parkun e Viroit, përfshirë edhe një pjesë të pasurisë së kërkueses.

2. Në këto kushte, kërkuesja ka paraqitur padi me anë të së cilës ka kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e vendosjes së kufizimeve nga VKM-ja nr. 322/2015 mbi tagrat e pronarit dhe ndalimin e cenimit të atyre tagrave, dhe urdhërimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP), Gjirokastrë që brenda 30 ditëve të hidhte gjurmën e projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas VKM-së. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë, me vendimin nr. 443, datë 18.07.2017, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë, duke urdhëruar ZVRPP-në, Gjirokastrë për të hedhur gjurmën e projekteve në parkun e Viroit dhe për të pajisur paditësit me certifikatë pronësie për pjesën e mbetur të pronës si pasojë e shpronësimit. Kundër vendimit ka paraqitur ankim kërkuesja.

3. Kërkuesja ka paraqitur edhe ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), duke kërkuar, ndër të tjera, shfuqizimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, për pjesën e padisë që ka shpallur moskompetencën lëndore. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 118, datë 08.10.2021, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, pasi kërkuesja nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive.

4. Në vijim të ankimit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 240 akti, datë 16.03.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ndërsa Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2388 (155), datë 15.04.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit.

5. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës, rezulton se kërkuesja, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit, Zyrës Përmbarrimore Gjirokastrë, me kërkesën për ekzekutimin e urdhrit të ekzekutimi nr. 144, datë 14.06.2023, lëshuar për vendimin e gjykatës së shkallës së parë, lënë në fuqi nga gjykata e apelit.

6. Zyra Përmbarrimore Gjirokastrë, me shkresën nr. 160 çështjes, nr. 2345 prot., datë 10.07.2023, i është drejtuar debitorit, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – të cilit i kanë kaluar të drejtat dhe detyrimet e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme – Drejtorisë Vendore

Gjirokastër (ASHK Gjirokastër), me lajmërim për ekzekutimin vullnetar të vendimit të formës së prerë.

7. Me shkresën nr. 160 çështjes, nr. 2791 prot., datë 07.09.2023, Zyra Përmbartimore Gjirokastër, i ka përcjellë kërkuases shkresën nr. 4193/1, datë 07.09.2023 të ASHK-së, Gjirokastër, me anë të së cilës kërkohet prej kërkuases paraqitja e aplikimit në rrugë digjitale. Kërkuësja rezulton të ketë aplikuar nëpërmjet platformës *e-Albania* me kërkesën nr. 6582, datë 18.09.2023.

8. Lidhur me këtë aplikim, ASHK-ja, Gjirokastër, me shkresën e datës 11.10.2023, i ka kërkuar kërkuases të depozitojë dokumentacionin original në rrugë postare, të cilin ajo rezulton ta ketë dërguar. Më tej, me shkresën e datës 25.10.2023, ASHK-ja, Gjirokastër i ka kërkuar kërkuases depozitimin edhe të aktit të trashëgimisë që mungonte, si dokument i domosdoshëm për t'u dorëzuar për atë qëllim, në bazë të ligjit. Në përgjigje kërkuësja i është drejtuar ASHK-së, Gjirokastër me aplikimin nr. 8549, datë 07.12.2023, duke pretenduar se ky dokumentacion nuk kishte lidhje me aplikimin në fjalë dhe nuk rezulton që ajo ta ketë depozituar atë.

9. Në vijim, me shkresën nr. 160 të çështjes nr. 3466/1 prot., datë 21.12.2023, Zyra Përmbartimore Gjirokastër i ka kërkuar debitorit të vijojë me ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës. Me përmbushjen e këtij afati, kërkuësja ka njoftuar zyrën përmbartimore për mosplotësimin e detyrimit të debitorit. Me shkresën nr. 5290/1, datë 10.01.2024, lënda “Kthim përgjigje”, ASHK-ja, Gjirokastër ka informuar zyrën përmbartimore se aplikimi i kërkuases ishte ende në trajtim nga specialisti *online* në datën e shkresës, duke sqaruar se në atë institucion ishte implementuar një sistem i ri. Gjithashtu, kjo zyrë e ka informuar atë se do të procedonte me kërkesë drejtuar Bashkisë së Gjirokastrës për vënien në dispozicion zyrtarisht të dokumentacionit të plotë të konfirmuar nga institucioni përkatës sipas VKM-së nr. 322/2015, shoqëruar me materialin hartografik ku janë konturuar pasuritë objekt kërkesë.

10. Në datën 13.05.2024 kërkuësja, nëpërmjet shërbimit postar, i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

## II

### Pretendimet e kërkuases

11. **Kërkuësja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se mosekzekutimi i vendimit nr. 443, datë 18.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, lënë në fuqi

me vendimin nr. 240, datë 16.03.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit, nga ana e debitorit, ASHK-së, Gjirokastër, është në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6, pika 1, të KEDNJ-së, ndaj, për rrjedhojë, kërkueses i është kufizuar edhe e drejta e pronës që në datën 15.04.2015.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkueses

12. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Në këtë vështrim, mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqësorit kushtetues.

13. Kërkuesja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor në shkallë të parë dhe apel, për të cilat ka kërkuar në Gjykatë konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutim të vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm, ndaj, për rrjedhojë, ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata bën gjykimin përfundimtar të ankesave individuale kundër çdo vendimi gjyqësor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese që pretendohet se janë cenuar. Në nenin 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, përmbushja e këtij kriteri është detajuar në dy hipoteza: i) kur kërkuesi ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive përpara se t'i drejtohet Gjykatës; ii) kur legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete juridike efektive në

dispozicion. Ai përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se i ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 12, datë 09.03.2021; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 8, datë 19.03.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, Kolegji konstaton se vendimi 443, datë 18.07.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është i formës së prerë dhe se Zyra Përmbartimore Gjirokastrë deri në datën 13.05.2024 nuk ka arritur ta ekzekutojë atë. Kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e tij brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6, pika 1, i KEDNJ-së dhe, për pasojë, edhe të së drejtës së pronës.

16. Në drejtim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive për çështje të mosekzekutimit në kohë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Kolegji thekson se ndërsa në jurisprudencën e saj të mëparshme Gjykata ka trajtuar çështje të tilla (*shih vendimet nr. 6, datë 23.02.2016; nr. 14, datë 30.03.2015; nr. 9, datë 27.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*), me ndryshimet që iu bënë Kodit të Procedurës Civile me ligjin nr. 38/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” (*KPC*), të cilat kanë hyrë në fuqi më 05.11.2017, ligji procedural ka parashikuar tashmë mjete ligjore, nëpërmjet të cilave individit i garantohet mbrojtja në rastet e cenimit të së drejtës për gjykimin ose ekzekutimin e vendimit gjyqësor brenda afatit të arsyeshëm. Në referim të këtyre ndryshimeve ligjore, neni 399/6, shkronja “ç”, i KPC-së parashikon se në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

17. Në këtë kuptim, në këndvështrim të këtyre dispozitave ligjore, në rastin konkret, Kolegji vlerëson se Gjykata nuk mund të investohet për shqyrtimin e kërkesës së kërkueses për konstatimin e cenimit të së drejtës për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë brenda afatit të arsyeshëm, pasi legjislacioni i brendshëm parashikon mjete juridike që i ofrojnë rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese. Për rrjedhojë, ajo duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës, në kuptim të

nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000 .

18. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.